REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH

Njësia Org. / Org.Jedinica / Org Unit 01
Nr.Prot: / Broj Prot: / Prot.No. 01-2654
Nr.i faqeve / Br.stranica / No.pages 15
Data: / Datum: / Date: 21/04/2021
Prishtinë / a

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health
Zyra e Ministrit/Ured Ministra/Office of the Minister

Nr. 222/IV/2021
Datë:20.04.2021

Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (GZ Nr. 7, 01 mars 2019), nenin 8 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, bazuar në nenin 5 paragrafi 2 nënparagrafi 2.5 të Ligjit Nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid-19 në Territorin e Republikës së Kosovës (GZ Nr. 3/2020, 25 gusht 2020), nenin 9 paragrafi 1.3 dhe nenin 89 të Ligjit nr.04/L-125 për Shëndetësi (GZ Nr. 13/2013, 07 maj 2020), në zbatim të Vendimit Nr. 01/11 të datës 15.03.2020 për Shpalljen e Emergjencës së Shëndetit Publik dhe të pikës 42 dhe 42 të Vendimit Nr.01/07 të datës 18.04.2021 për Masat e Përgjithshme dhe të Veçanta për Kontrollin, Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19, nxjerr:

V E N D I M

Për aprovimin e Udhëzuesit të përkohshëm - Aplikimi i masave të përgjithshme dhe të veçanta për parandalimin dhe luftimin e COVID-19 në institucionet arsimore të të gjitha niveleve (verzioni 1.0)

1. Aprovohet Udhëzuesi i përkohshëm - Aplikimi i masave të përgjithshme dhe të veçanta për parandalimin dhe luftimin e COVID-19 në institucionet arsimore të të gjitha niveleve (verzioni 1.0).

2. Udhëzuesi është i obligueshëm për të gjithë personat dhe sektorët ndaj të cilëve zbatohet.

3. Shtojca e bashkangjitur këtij vendimi, është pjesë përbërëse e tij.

4. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm që përmes Qarkores Informative të informoj të gjitha institucionet dhe palët e interesit për aprovimin e këtij udhëzuesi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Shëndetësisë.

Dr. Arben Vitia
Ministër i Shëndetësisë

Vendim i dërgohet:
- Zyrës së Kryeministrit;
- Të gjitha ministrive
- Sekretarit të Përgjithshëm të MSh;
- Departamentit ligjor të Msh;
- Divizionit për komunikim me publikun të Msh;
- Arkivit të MS

Shtojca 1: Udhëzues i përkohshëm - Aplikimi i masave të përgjithshme dhe të veçanta për parandalimin dhe luftimin e COVID-19 në institucionet arsimore të të gjitha niveleve (verzioni 1.0)

Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravstva / Ministry of Health

UDHËZUES I PËRKOHSHËM

APLIKIMI I MASAVE TË PËRGJITHSHME DHE TË VEÇANTA PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E COVID-19 NË INSTITUCIONET ARSIMORE TË TË GJITHA NIVELEVE

Prishtinë, Prill 2021

Verzioni 1.0

Udhëzues i veçantë për aplikimin e masave për parandalimin dhe luftimin e COVID-19 në institucionet e arsimit parauniversitar

Pavarësisht nga niveli i transmetimit në komunitet, është e rëndësishme që institucionet parashkollore dhe shkollore të përdorin dhe të fuqizojne strategjitë e parandalimit të transmetimit të SARS-CoV-2. Pesë strategji kryesore të parandalimit janë themelore për shpërndarjen e sigurt të udhëzuesve personal dhe që ndihmojnë në parandalimin e transmetimit të COVID-19 në Institucionet e Arsimit Parauniversitar:

1. Përdorimi universal dhe korrekt i maskave
2. Distanca fizike
3. Pastrimi i duarve dhe higjiena e frymëmarrjes
4. Pastrimi dhe mirëmbajtja e mjediseve të shëndetshme
5. Gjurmimi i kontakteve në kombinim me izolimin dhe karantinën

Institucionet e arsimit parauniversitar që ofrojnë udhëzues personal duhet t'i japin përparësi dy strategjive parandaluese:

1. Duhet të kërkohet përdorim universal dhe korrekt i maskave
2. Distanca fizike duhet të maksimizohet në masën më të madhe të mundshme

Përdorimi i strategjive të shumëfishta - ndonjëherë të quajtura **parandalim i shumëfishtë** - siguron mbrojtje më të madhe në ndëprerjen e zinxhirëve të transmetimit sesa zbatimi i një strategjie të vetme. Udhëzuesi rekomandon përdorimin e dy ose më shumë strategjive të parandalimit, me theks të veçantë në përdorimin universal dhe korrekt të maskave dhe distancimin fizik.

Përpjekjet e mëposhtme të shëndetësisë publike ofrojnë masa shtesë të mbrojtjes COVID-19 në Institucionet e arsimit parauniversitar:

a. Testimi për të identifikuar individët me infeksion SARS-CoV-2 për të kufizuar transmetimin dhe shpërthimet
b. Vaksinimi për mësimdhënësit, edukatoret dhe stafin sa më shpejt të jetë e mundur

1. Përdorimi universal dhe korrekt i maskave

Parimi thelbësor për maskat: Maskat duhet të mbahen në çdo kohë, nga të gjithë personat në objektet shkollore, me përjashtime të caktuara për persona, ose për disa ambiente ose aktivitete të caktuara, të tilla si gjatë ngrënies ose pirjes. Maskat duhet të barten në të gjitha mjediset klasore dhe ato jo-klasore, duke përfshirë korridoret, zyrat e shkollës, toaletet, palestrat, etj.

- Politikat e bartjes së maskave për të gjithë nxënësit, mësimdhënësit dhe stafin vendosin pritshmërinë që njerëzit të përdorin maska në të gjithë shkollën.

- Maskat më efektive janë ato nga materiali i pambukut, në dy ose tre shtresa pëlhure. Nuk rekomandohen maska me valvula ose ventil të ajrit, maskat e lirshme dhe ato që nuk përshtaten/puthiten siç duhet në fytyrë.
- Shumica e nxënësve, përfshirë ata me aftësi të kufizuara, mund të tolerojnë dhe të mbajnë maskë në mënyrë të sigurt. Sidoqoftë, një nëngrup i ngushtë i nxënësve me aftësi të kufizuara mund të mos jenë në gjendje të mbajnë maskë ose nuk mund të mbajnë maskë në mënyrë të sigurt. Nëse një fëmijë me aftësi të kufizuara nuk mund të mbajë maskë, të mbajë distancë fizike ose t'u përmbahet kërkesave të tjera të shëndetit publik, nxënësi ka ende të drejtë për një arsim të duhur, (të gjithë personat që e rrethojnë në asnjë moment nuk guxojnë të hjekin maskat dhe duhet të respektojnë distancën). Përdorimi i maskave duhet të aplikohet në autobusët e shkollës dhe transportin tjetër publik; sistemet shkollore duhet të ndërmarrin hapat e duhur për të siguruar zbatimin e bartjes se maskave nga nxënësit, stafi dhe të tjerët.
- Nëse vizitorët lejohen në shkollë, atyre u kërkohet të mbajnë maska gjatë gjithë kohës dhe duhet të mbajnë distancë fizike nga të tjerët.
- Menaxhmeti, stafi arsimor dhe stafi tjetër i shkollës duhet të inkurajojnë modelimin e përdorimit korrekt dhe të qëndrueshëm të maskave.

2. Distanca fizike

Parimi kryesor për distancën fizike: Vendosni udhëzuesit shkollor (sinjalizime në dysheme dhe posterë në hapësira të dukshme dhe të frekuentuara) dhe zbatoni ndërhyrjet strukturore për të promovuar distancën fizike mes personave. Sinjalizimi duhet të jetë i qasshëm dhe i kuptueshëm për fëmijët me aftësi të kufizuara shqisore dhe intelektuale respektivisht.

Rregullat në klasë

Në instutucionet parashkollore, shkollat fillore dhe të mesme, fëmijët/nxënësit duhet të jenë të paktën 2 metra larg.

Rregullat për 2 metër distancë:

- Në mes të rriturve (mësimdhënësve, edukatorëve dhe stafit tjetër), mes të rriturve dhe nxënësve, në çdo kohë në ndërtesën e shkollës.
- Maskat nuk mund të mbahet, si psh.: gjatë ngrënies apo pirjes.
- Gjatë aktiviteteve kur ndodh frymëmarrja e shtuar, të tilla si të kënduarit, të bërtiturat, koret, sportet dhe ushtrimet. Zhvendosni këto aktivitete jashtë në ambient të hapur ose në hapësirë të madhe, të ajrosur mirë, kur kjo është e mundur.
- Në zona të përbashkëta si korridoret shkollore, sallat, amfiteatrot, këndet e lojërave.
- Përdorni ndarjen në grupe të vogla të nxënesve dhe mbani 2 metra distancë midis nxënësve kur është e mundur. Kufizoni kontaktin midis grupeve.
- Largoni orenditë e panevojshme dhe bëni ndryshime të tjera në paraqitjen në klasë për të maksimizuar distancën midis fëmijëve/nxënësve.
- Tavolinat e kthyera në të njëjtin drejtim, nëse është e mundur.
- Eliminoni ose zvogëloni ndërveprimet jo-esenciale me prani fizike midis mësimdhënësve dhe stafit gjatë takimeve, drekave dhe situatave të tjera që mund të çojnë në transmetim nga i rrituri te i rrituri.

- Vizitorët: Kufizoni sa më shumë vizitorë, vullnetarë dhe aktivitete jo-esenciale që përfshijnë grupe ose organizata të jashtme - veçanërisht me njerëz që nuk janë nga zona gjeografike lokale (për shembull, jo nga i njëjti komunitet, rajon, qytet). Kërkoni nga të gjithë vizitorët të mbajnë maska dhe distancë fizike 2 metra nga të tjerët.
- Transporti: Krijoni distancë midis fëmijëve në autobusët e shkollës (për shembull, ulni nga një fëmijë në rresht, kaloni rreshtat), me 50% kapacitet të autobusit. Maskat obligohen në autobusët shkollorë dhe format e tjera të transportit publik. Hapni dritaret për të përmirësuar ventilimin kur nuk rrezikohet siguria.

3. Pastrimi i duarve dhe higjiena e frymëmarrjes

Parimi thelbësor për pastrimin e duarve dhe mirëmbajtjen e higjienës së frymëmarrjes: Nëpërmjet njësive edukativo-arsimore gjithëpërfshirëse dhe të vazhdueshme, mësoni fëmijët për pastrimin e duhur të duarve, fuziqoni sjelljet dhe siguroni furnizime adekuate. Sigurohuni që mësimdhënësit dhe stafi të praktikojnë mënyrat e duhura të pastrimit të duarve dhe higjienës së frymëmarrjes-vendosni poster që tregojnë për larjen dhe dezinfektimin e drejtë të duarve. Materiali edukativo-promovues duhet të jetë i qasshëm dhe i kuptueshëm për fëmijët me aftësi të kufizuara shqisore dhe intelektuale respektivisht.

- Praktikoni mënyrën e pastrimit të duarve me ujë dhe sapun për të paktën 20 sekonda dhe fuqizoni monitorimin për të siguruar respektimin e tyre nga ana e nxënësve, mësimdhënësve dhe stafit. Nëse pastrimi i duarve nuk është i mundur, duhet të përdoret dezinfektues me bazë alkooli, që përmban 60-70% alkool.
- Inkurajoni nxënësit dhe stafin të mbulojnë gojën dhe hundën me parakrah gjatë kollitjes dhe teshtitjes, të përdorin faculetë kur nuk mbajnë maskë dhe menjëherë të pastrojnë duart pas kollitjes, teshtitjes ose largimit të sekreteve nga hunda dhe goja.
- Të iu ofrohet ndihmë nxënësve me aftësi të kufizuara që mund të kenë nevojë për ndihmë në larjen e duarve dhe higjienën e frymëmarrjes.
- Furnizime adekuate: Mbështetni sjelljet e shëndetshme të higjienës duke siguruar furnizime të përshtatshme përfshirë sapun, faculeta, maskat e fytyrës (nëse është e mundur) dhe koshat e mbeturinave pa prekje/me pedale të këmbës. Nëse sapuni dhe uji nuk janë në dispozicion, shkollat mund të sigurojnë dezinfektues dore me bazë alkooli që përmban të paktën 60-70 % alkool (për stafin dhe fëmijët më të rritur që mund të përdorin sigurtë ato).

4. Pastrimi dhe mirëmbajtja e mjediseve të shëndetshme

Parimi themelor për pastrimin dhe mirëmbajtjen e ambienteve të shëndetshme: Bëni ndryshime në hapësirat fizike për të ruajtur një mjedis të shëndetshëm, duke përfshirë përmirësimin e ventilimit. Pastroni në mënyrë rutinore dhe të vazhdueshme sipërfaqet me prekje të lartë (të tilla si dorëzat e derës, ndërprerësit e dritës, bangat, parmakët).

- Ventilimi: **Përmirësoni ventilimin** në masën sa është e mundur, për të rritur qarkullimin e ajrit të jashtëm, për të rritur shpërndarjen e ajrit të pastër dhe për të larguar ndotësit e mundshëm. Kjo mund të arrihet përmes disa veprimeve:
  - Ajrosja e mirë e ambienteve-klasave dhe sallave

- Sigurohuni që pajisjet e ventilimit dhe klimatizimit të maksimizojnë ventilimin
- Përdorni aspiratorët e shkarkimit në toalete dhe kuzhina
- Hapni dritaret në autobusë dhe mjetet tjera të transportit, nëse kjo nuk paraqet rrezik për sigurinë.

- Pastrimi: Pastroni rregullisht sipërfaqet e prekura shpesh (për shembull, pajisjet e këndit apo sheshit të lojërave, dorëzat e dyerve, dorezat e dollapëeve, rubinetat e ujit, tualetet) brenda shkollës dhe në autobusët e shkollës të paktën çdo ditë ose në mes të përdorimit sa më shumë që të jetë e mundur.
- Ndarja e objekteve: Mos e inkurajoni ndarjen e gjërave personale, veçanërisht ato që pastrohen me vështirësi.
- Sistemet e ujit: Merrni masa për të siguruar që të gjitha sistemet dhe objektet e ujit (për shembull, rubinetat e lavamanit, burimet dekorative) janë të sigurta për t'u përdorur pas një mbyllje të zgjatur të objektit.

5. Gjurmimi i kontaktit në kombinim me izolimin dhe karantinën

Parimi themelor për gjurmimin e kontakteve: Institucionet e arsimit parauniversitar duhet të bashkëpunojnë me IKShPK, MSh, MAShTI, DKA duke respektuar ligjet e zbatueshme, për të siguruar në mënyrë konfidenciale informacionin në lidhje me personat e diagnostikuar ose të ekspozuar ndaj COVID-19. Nxënësit/fëmijët, mësimdhënësit/edukatoret dhe stafi teknik/administrativ të cilët rezultojnë pozitiv në SARS-CoV-2 duhet të izolohen, kurse kontaktet e ngushta të tyre të karantinohen.

- **Qëndrimi në shtëpi kur është e nevojshme:** Udhëzoni mësimdhënësit, stafin dhe familjet e tyre, për procedurat e vetizolimit dhe rikthimit në shkollë/kopsht. Nxënësit, mësimdhënësit dhe personeli që kanë simptoma duhet të qëndrojnë në shtëpi dhe të referohen tek shërbimet shëndetësore për testim dhe trajtim. Shkollat duhet të praktikojnë praktika fleksibile të pushimit mjekësor që u mundësojnë mësuesve dhe stafit të qëndrojnë në shtëpi kur ata janë të sëmurë, janë të ekspozuar ose kujdesen për dikë që është i sëmurë me COVID-19. Në rast se mësimdhënësi është rast kontakti dhe duhet të qëndroj i izoluar në shtëpi, atëhërë shkolla duhet të bëjë orarin për kyçjen e mësimdhënsit në mësimin online me nxënës sipas orarit të përcaktuar nga shkolla.
- **Izolimi** nënkupton ndarjen e personave të diagnostikuar me COVID-19 nga ata që nuk janë të infektuar. Personave të tillë duhet t'u ofrohet kujdesi i nevojshëm mjekësor gjatë izolimit. Çdo rast i dyshuar, i mundshëm ose i konfirmuar i COVID-19 duhet të kujdeset që të jetë në izolim. Nxënësit/fëmijët, mësimdhënësit/mësuesit dhe personeli që janë në izolim duhet të qëndrojnë në shtëpi dhe të ndjekin udhëzimet e IKShPK se kur është e sigurt që ata të dalin nga vetizolimi.
- **Hulumtimi i rastit dhe gjurmimi i kontakteve**: Shkollat duhet të bashkëpunojnë me institucionet relevante shëndetësore për të lehtësuar hulumtimin sistematik të rastit, gjurmimin e kontakteve të nxënësve/fëmijëve, mësimdhënësve/edukatoreve dhe stafit të infektuar si dhe izolimin e vazhdueshëm të rasteve dhe karantinën e kontakteve të ngushta. Që shkollat të qëndrojnë të hapura, institucionet shëndetësore duhet të sigurojnë që ata të bëjnë mjaftueshëm gjurmime të kontakteve dhe të njoftohen brenda 48 orëve për rezultat të testit. Identifikimi i shpejtë, karantina dhe monitorimi i kontakteve të ekspozuara ndaj SARS-CoV-2 mund të ndërprejnë në mënyrë efektive zinxhirin e transmetimit dhe të parandalojnë përhapjen e mëtejshme të virusit.

- **Përkufizimi i kontaktit të ngushtë:** është personi që ishte brenda 2 metrave afër një personi të diagnostikuar me COVID-19 në kohëzgjatje prej 15 minutash ose më shumë për një periudhë 24 orëshe. Përkufizimi i një kontakti të ngushtë zbatohet pavarësisht nëse personat kishin vendosur maskë.
- Për shkollat që përdorin më pak se 2 metra distancë midis nxënësve në klasë, përkufizimi i kontakteve të ngushta nuk duhet të ndryshojë. Nxënësit që ulen më pak se 2 metra pranë një nxënësi ose personi tjetër të diagnostikuar me COVID-19 në kohëzgjatje prej 15 minutash ose më shumë duhet të izolohen në shtëpi dhe të referohen për testim.
- **Karantina** duhet të përdoret për nxënësit, mësimdhënësit dhe stafin që mund të jenë ekspozuar ndaj COVID-19. Kontaktet e ngushta, të identifikuara përmes gjurmimit duhet të karantinohen, përpos në rastet kur ata janë të vaksinuar plotësisht, ose kanë rezultuar pozitiv në 3 muajt e fundit dhe nuk kanë ndonjë simptomë. Nxënësit, mësimdhënësit dhe personeli që janë në karantinë duhet të qëndrojnë në shtëpi, nuk lejohet të dalin nga shtëpia pos për nevoja të veçanta dhe të ndjekin udhëzimet e IKShPK-së kur është e sigurt që ata të lirohen. Nëse një fëmijë me aftësi të kufizuara kërkohet të qëndrojë në karantinë, shkolla është e obliguar të ofrojë shërbime në përputhje me ligjet në fuqi.

6. Skenarët e MASHTI-it për zhvillimin e vitit shkollor 2020-2021

- Skenari A: Mësimi në shkollë
- Skenari B: Mësimi i kombinuar (dy ditë në shkollë - tri ditë online) dhe
- Skenari C: Mësimi në distancë dhe online

Indikatori ndërkombëtar i nivelit të moderuar të prevalencës së pandemisë COVID - 19, sipas të cilit një pandemi konsiderohet e moderuar nëse ka më pak se dhjetë (10) raste të infektimeve për 10,000 banorë.

7. Udhëzim për reagim:

Ndërrimi i skenarëve1 (a→ b ose b→c) në bazë të numrit të personave të infektuar në sistemin arsimor do të jetë si vijon:

- Niveli i klasës: nëse paraqitet një (1) rast i infektimit për klasë / grup / paralele
- Ilustrim: nëse paraqitet një rasti i infektimit të një nxënësi, pos masave për trajtimin e rastit për nxënësin e caktuar (të parashtuara në Udhëzuesin kryesor të MASHTI), i tërë grupi i caktuar do të kaloj në mësim online. Pas marrjes se rekomandimeve nga IKShPK mblidhet task-forca e shkollës dhe merr vendimin përkatës.
- Aplikohen rregullat nga Udhëzuesi i IKShPK-së/MSh. Të gjitha vendimet merren nga task-forca e nivelit përkatës.
- Niveli i shkollës: një (1) rast i infektimit për 200 nxënës në ditë gjatë një jave.
- Ilustrim: Nëse një shkollë me 1000 nxënës ka më shumë se pesë raste të infektimeve të reja brenda një dite (gjatë tri - pesë ditëve të punës), atëherë mblidhet task-forca për të vlerësuar nëse e tërë shkolla kalon në regjim të mësimit online dhe në distancë.
- Komunat me shkallë më të lartë të infektimit se shkalla e moderuar 10/100,000 do të reagojnë edhe më rreptësisht: nëse paraqitet 1 rast infektimi për 400 nxënës - sidomos në muajt e parë të vitit shkollor. Të gjitha vendimet merren nga task-forca e nivelit përkatës.

---

[1] Në rast të paraqitjes së rasteve të infeksionit kalohet nga skenari a - b - c

- Niveli i komunës: për komunën e caktuar do të jetë dhjetë (10) e më shumë raste për 100,000 banorë në ditë.
- Ilustrim: Nëse komuna e caktuar me 50,000 banorë ka më shumë se pesë raste të infektimeve të reja në ditë për një periudhë prej një jave, atëherë DKA dhe autoritetet komunale (task forca komunale – në konusltim me IKSHPK/MSH) vendosin nëse do të kalojnë të gjitha institucionet arsimore në regjimin e mësimit online (varësisht nga natyra, origjina dhe shtrirja e rasteve të infektimeve). Të gjitha vendimet merren nga task-forca e nivelit përkatës.

8. Cikli i rikthimit

Pas skadimit të infeksionit në rastet individuale, Task Forca e shkollës rekomandon që rikthimi të bëhet sipas dinamikës në vijim:

1. Niveli i klasës: 2 javë dhe vlerësimi i task-forcës së shkollës për klasën/grupin/paralelen e caktuar
2. Niveli i shkollës: Së paku 2 javë dhe vlerësimi i task-forcës së shkollës për shkollën e caktuar
3. Niveli komunal: Së paku 2 javë, përgatitjet e dëshmuara, dhe një vlerësim nga IKSHPK për komunën e caktuar.

Ilustrim: Nëse të gjitha institucionet arsimore në një komunë kanë kaluar në mësim online për shkak të numrit të rasteve të reja sipas kriterit 10/100,000 gjatë një jave, atëherë për kthim në objekte shkollore do të kërkohen së paku tri javë dhe rekomandimi pozitiv nga IKSHPK pas një vlerësimi paraprak.

9. Personeli arsimor

MAShTI dhe DKA do të ristrukturojnë personelin ekzistues sipas nevojës, dhe do të angazhojnë personel shtesë arsimor me vendim të veçantë nga qeveria, me qëllim të plotësimit të kërkesave për mësimdhënës pas ndarjes së paraleleve në grupe të vogla dhe për zëvendësimin e personelit që mund të infektohet në vendin e punës.

Në secilin rast kur një mësimdhënës tregon simptoma të ngjashme me Covid-19, menaxhmenti i shkollës duhet të informojë DKA-në/QKMF përkatëse, dhe DKA duhet të:

- gjejë zëvendësim të përkohëshëm brenda stafit të shkollës menjëherë
- sigurojë testimin për covid – 19 në afatin sa më të shkurtë për mësimdhënësin dhe
- në rast të rezultatit pozitiv – të gjejë zëvendësim nga mësimdhënësit e shkollës nese ka mundësi ose nga lista e mësimdhënësve rezervë në komunë. Në këtë rast të gjithë nxënësit e klasës përkatëse kalojnë në mësim online për 2 javë.

Udhëzimet e veçanta për aplikimin e masave për parandalimin dhe luftimin e COVID-19 në institucionet e arsimit të lartë

Sa më shumë dhe sa më gjatë që një person ndërvepron me të tjerët, aq më i lartë është rreziku i përhapjes së COVID-19 në komunitet. Rreziku ndikohet gjithashtu nga faktorë të tillë si niveli i transmetimit të infeksionit në komunitet dhe zbatimi i masave parandaluese nga ana e popullatës, të tilla si përdorimi i maskave, distanca fizike dhe higjiena e duarve. Rreziku i përhapjes së COVID-19 rritet në Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL) në raport me nivelin e transmetimit të COVID-19 në komunitet dhe si më poshtë:

10. Rreziku më i ulët

- IAL dhe studentët zhvillojnë aktivitete, mësime dhe ngjarje tjera të ndërlidhura me procesin mësimor- **vetëm online**

11. Rreziku i ulët

- Studentët, stafi akademik dhe personeli joakademik ndjekin hapat për të mbrojtur veten dhe të tjerët në çdo kohë, duke përfshirë përdorimin e duhur të maskave të fytyrës, distancën fizike dhe higjienën e duarve.
- Modeli i kombinuar i të mësuarit: Studentët marrin pjesë në mësimin online, kurse ushtrimet laboratorike, eksperimentale dhe klinike, mësimi individual si dhe praktika në shkolla realizohet me prezencë fizike meqe nuk mund te realizohet nga distanca.
- Studentët, stafi akademik dhe personeli joakademik marrin pjesë në mësim, aktivitete dhe ngjarje që lejojnë individët të qëndrojnë të vendosur të paktën 2 metër distancë (p.sh., klasë mësimi me ulëse individuale të vendosur 2 metër larg).
- Zbatoni dhe mbështesni respektimin e përpiktë të orareve kohore dhe termineve alternative të mësimit
- Rekomandohet që IAL të shohin mundësinë e shkurtimit të orëve mësimore me prani fizike në 30 minuta dhe të zvogëlohet numëri i orëve mësimore brenda ditës (maksimumi 6 orë)
- Studentët, stafi akademik dhe personeli nuk ndajnë gjërat mes vete (p.sh., pajisje laboratorike, arti ose rekreative).
- Planifikimet e rregullta për dezinfektim të hapësirave mësimore (d.m.th., në kohë dhe në mënyrë të vazhdueshme) dhe pajisjet laboratorike apo eksperimentale.

12. Rreziku mesatar

- Studentët, stafi akademik dhe personeli joakademik ndjekin hapat për të mbrojtur veten dhe të tjerët në çdo kohë, duke përfshirë përdorimin e duhur të maskave të fytyrës, distancën fizike dhe higjienën e duarve.
- Modeli i kombinuar i të mësuarit: Studentët marrin pjesë në një kombinim të të mësuarit online dhe të mësuarit me prezencë fizike, për ushtrimet laboratorike, eksperimentale dhe klinike, mësimin individual si dhe praktikën në shkolla.

- Studentët, stafi akademik dhe personeli joakademik marrin pjesë në tubime dhe ngjarje të kufizuara/të vogla jashtë klase
- Studentët, stafi akademik dhe personeli joakademik ndajnë gjësendet në mënyre të kufizuar (p.sh., ndarja e objekteve është e kufizuar në një person në të njëjtën kohë për pajisje laboratorike, arti ose rekreative që nuk mund të blihen ose caktohen individualisht, që duhet të dezinfektohen midis përdorimeve sa herë të jetë e mundur)
- Pastrimi dhe dezinfektimi i rregullt i hapësirave/zonave që preken shpesh sipas planifikimit, me disa përjashtime.

13. Rreziku më i lartë

- Studentët, stafi akademik dhe personeli joakademik ndjekin hapat për të mbrojtur veten dhe të tjerët në çdo kohë, duke përfshirë përdorimin e duhur të maskave të fytyrës, distancën fizike dhe higjienën e duarve
- Studentët dhe stafi akademik zhvillojnë **vetëm me prezencë fizike** mësime, aktivitete dhe ngjarje tjera edukativo-arsimore
- Studentët, stafi akademik dhe personeli joakademik marrin pjesë në tubime dhe ngjarje të vogla jashtë klase
- Studentët, stafi akademik dhe personeli joakademik ndajnë hapësirat (p.sh., ndarja e hapësirave është e kufizuar në një grup studentësh në të njëjtën kohë për pajisje laboratorike, arti ose rekreative që nuk mund të blihen ose caktohen individualisht, që duhet të dezinfektohen midis përdorimeve sa herë të jetë e mundur)
- Pastrimi dhe dezinfektimi jo i rregullt i hapësirave/zonave që preken shpesh.

14. Rreziku shumë i lartë

- Përdorimi i transportit publik, autobusëve ose automjeteve të tjera të mbyllura
- Studentët, stafi akademik dhe personeli joakademik nuk i respketojnë masat e tilla si përdorimi i duhur i maskave të fytyrës, distanca fizike si dhe higjiena e duarve për të mbrojtur veten dhe të tjerët.
- Studentët dhe stafi akademik te cilet rregullisht merren me mësime, aktivitete dhe ngjarje me prezencë fizike
- Studentët, stafi akademik dhe personeli joakademik marrin pjesë në tubime dhe ngjarje të mëdha shoqërore jashtë klase.
- Pastrimi dhe dezinfektimi jo i rregullt i hapësirave/zonave që preken shpesh.

Promovimi i sjelljeve që zvogëlojnë përhapjen e COVID-19

IAL të zbatojnë strategjitë për inkurajimin e sjelljeve që ulin përhapjen e COVID-19:

15. Qëndrimi në shtëpi ose vet-izolimi

Nëse merret vendim për kthim në mësim me prezencë fizike, para kthimit, informoni studentët, stafin akademik dhe personelin joakademik: që kanë qenë të sëmurë me simptoma COVID-19, kanë rezultuar pozitivë për COVID-19 ose janë ekspozuar potencialisht dikujt me COVID-19 të ndjekin udhëzimet e IKShPK për vet-izolim ose qëndrim në shtëpi.

Studentët, stafi akademik dhe personeli joakademik **duhet të qëndrojnë në shtëpi** kur kanë rezultuar pozitiv ose shfaqin simptoma të COVID-19.

16. Pastrimi i duarve dhe higjiena e frymëmarrjes

Rekomandoni dhe fuqizoni pastrimin e duarve me ujë dhe sapun për të paktën 20 sekonda. Nëse sapuni dhe uji nuk janë në dispozicion, mund të përdoret dezinfektues me bazë alkooli 60-70%. Inkurajoni studentët, stafin akademik dhe personelin joakademik për të mbuluar kollitjen dhe teshtitjen me faculetë ose me përdorim të pjesës së brendshme të bërrylit. Faculetat e përdorura duhet të hidhen në shportë dhe duart duhet të pastrohen menjëherë me ujë dhe sapun për të paktën 20 sekonda.

17. Përdorimi universal dhe korrekt i maskave

Rekomandoni dhe obligoni përdorimin e maskave nga studentët, stafi akademik dhe personeli joakademik. Shumë njerëz me COVID-19 janë asimptomatikë ose kanë vetëm simptoma të lehta, kështu që ata mund të mos e dinë që janë të infektuar. Përdorimi i maskave për të parandaluar përhapjen e spërklave është një strategji e rëndësishme për të ndihmuar në parandalimin e përhapjes së COVID-19. Informatat rreth përdorimit të duhur të maskave, duhet t'u sigurohet të gjithë studentëve, stafit akademik dhe personelit joakademik.

Maska **nuk** duhet të bartin:

- ✓ Foshnjet dhe fëmijët më të vegjël se 2 vjeç
- ✓ Kushdo që ka probleme me frymëmarrjen ose është pavetëdije
- ✓ Kushdo që është i paaftë ose nuk është në gjendje të largoj maskën pa ndihmën e tjetrit

18. Furnizime adekuate

Furnizimet përfshijnë materiale të domosdoshme si: sapun, faculetë, dezinfektues me bazë alkooli 60-70%, maska (sipas mundësive) dhe shportë mbeturinash pa prekje (mundësisht të mbuluara).

19. Shenjëzimet dhe vendosja e materialeve edukativo promovuese

Vendosni shenjëzime në vendet shumë të dukshme dhe të frekuentuara (p.sh., hyrjet e ndërtesave, tualetet, zonat e ngrënies) që promovojnë masat e përditshme mbrojtëse (të tilla si mënyra e pastrimit të duarve, distanca fizike, maska). Përdorni një gjuhë të thjeshtë, të qartë dhe efektive në lidhje me sjelljet që parandalojnë përhapjen e COVID-19. Përdorni metodat e komunikimit që janë të arritshme për të gjithë studentët, stafin akademik dhe personelin joakademik, dhe vizitorët e tjerë, përfshirë prindërit ose kujdestarët.

II Mirëmbajtja e mjediseve të shëndetshme

IAL të zbatojnë strategjitë për të ruajtur ambiente të shëndetshme:

20. Pastrimi dhe dezinfektimi

- Pastroni dhe dezinfektoni sipërfaqet e prekura shpesh (p.sh., dorëzat e dyerve, bateritë e lavamanit, burimet e pirjes, parmakët, tavolinat, tastierat) brenda ambienteve të IAL të paktën çdo ditë ose ndërmjet përdorimit, sa më shumë që të jetë e mundur.
- Përdorimi i objekteve të përbashkëta (p.sh. pajisjet laboratorike, pajisjet kompjuterike, tavolinat) duhet të kufizohen kur është e mundur, ose të pastrohen dhe dezinfektohen mes përdorimit.
- Inkurajoni studentët, stafin akademik dhe personelin joakademik që të përdorin dezinfektues për të pastruar tavolinat e përbashkëta, pajisjet e laboratorit dhe objektet të tjera të përbashkëta përpara dhe pas përdorimit.
- Nëse automjetet e transportit (p.sh. autobusët apo veturat zyrtare) përdoren nga IAL, shoferët duhet të praktikojnë të gjitha veprimet e sigurisë dhe protokollet si për personelin tjetër (p.sh., higjiena e duarve, maskat).
- Vendosni dezinfektues për duar pranë zonave me prekje të lartë, në hyrje dhe dalje të institucioneve.

21. Ndarja e pajisjeve

Shmangni ndarjen e pajisjeve elektronike, librave, stilolapsave dhe mjeteve të tjera të mësimit. Siguroni furnizime adekuate për të minimizuar ndarjen e materialeve që përdoren më shumë (p.sh., caktimin e secilit student për pajisjet e tyre artistike, pajisjet laboratorike, kompjuterët) ose kufizimin e përdorimit të pajisjeve nga një grup studentësh në të njëjtën kohë pastaj pastrimin dhe dezinfektimin mes përdorimit.

22. Ventilimi

<u>Përmirësoni ventilimin</u> në masën sa është e mundur, për të rritur qarkullimin e ajrit të jashtëm, për të rritur shpërndarjen e ajrit të pastër dhe për të larguar ndotësit e mundshëm.

Kjo mund të arrihet përmes disa veprimeve:

- Ajrosja e mirë e ambienteve - sallave dhe kabineteve
- Pajisjet e ventilimit dhe klimatizimit të maksimizojnë ventilimin
- Aspiratorët e shkarkimit në toalete dhe kuzhina

- Kur kushtet meteorologjike lejojnë, hapni dritaret dhe dyert për të rritur qarkullimin e ajrit të freskët.

23. Modifikimi i vendosjes së orendive

- Ulëset dhe tavolinat të vendosen në hapësirë të paktën 2 metër larg njëra tjetrës.
- Në sallat e ligjëratave, rregulloni uljen e karrigeve dhe kalimin e rreshtave për të siguruar distancën 2 metra midis studentëve.
- Organizoni orë me më pak studentë, në salla/hapësira më të mëdha.
- Organizoni ligjërata/ushtrime në platformën virtuale, kur është e mundur.

Intervenimet inxhinierike
Konsideroni vendosjen e dyerve automatike ose dyerve që mund të hapen pa i prekur me duar (p.sh., të shtyhen me krah).

Mirëmbajtja e intervenimeve të shëndetshme

IAL të zbatojnë strategjitë për të ruajtur intervenimet e shëndetshme:

24. Mbrojtja për studentët, stafin akademik dhe personelin joakademik në rrezik më të lartë për sëmundje të rëndë nga COVID-19

IAL t'iu ofrojnë mundësi stafit akademik dhe personelit joakademik të cilët janë më të rrezikuar nga COVID-19 (personat më në moshë dhe të tjerët me sëmundje shoqëruese), që të kufizojnë ekspozimin e tyre në mënyrë që të ulin rrezikshmërinë (p.sh. të punojnë online ose të modifikohen përgjegjësitë e punës së tyre).

Ofroni mundësi për studentët me rrezik më të lartë për sëmundje të rëndë që të kufizojnë rrezikun e ekspozimit të tyre (p.sh. mundësitë virtuale të të mësuarit).

25. Mësimi virtual-online

- Inkurajohet mësimi në platformat virtuale-online.
- Ofroni takimet në platformat virtuale-online me ose tele-konferencë në vend të takimeve me pjesëmarrje fizike.
- Në rast se mbajtja e orëve mësimore me prani fizike është e paevitueshme, rekomandohet që IAL të shohin mundësinë e shkurtimit të orëve mësimore me prani fizike në 30 minuta dhe të zvogëlohet numëri i orëve mësimore brenda ditës (maksimumi 6 orë)
- Ofroni shërbime mbështetëse për studentët në mënyrë virtuale, aq sa është e mundur.

26. Mbajtja e konsultave me studentë, kolokfiumeve dhe provimeve

- Në mënyrë që të ruhet cilësia e arsimit të lartë, inkurajohet stafi akademik që të mbajnë konsulta të drejtpërdrejta me studentë, duke respektuar masat e nevojshme parandaluese të COVID-19, ndërsa nëse kjo nuk është e mundur, ata të jenë në dispozicion të studentëve për konsultime online.
- Sipas mundësive infrastrukturore të IAL, inkurajohet mbajtja në mënyrë virtuale e provimeve/kolokfiumeve me studentë, ndërsa nëse IAL vendosin që provimet/kolokfiumet të mbahen me prani fizike, ato të organizohen në mënyrë të tillë që të sigurojnë distancën e nevojshme fizike të të gjithë pjesëmarrësve, mbajtjen e maskave si dhe higjienën e duhur të duarve dhe hapësirave.

27. Rregulloret e pushimit mjekësor dhe mungesës së justifikuar

Pushimet mjekësore u mundësojnë studentëve, stafit akademik dhe personelit joakademik të qëndrojnë në shtëpi ose të vet izolohen kur janë të sëmurë, janë të ekspozuar ose kur kujdesen për dikë që është i sëmurë me COVID-19.

- Rregulloret e pushimit dhe mungesës së arsyeshme duhet të jenë fleksibile, të mos jenë ndëshkuese dhe duhet të lejojnë që punonjësit dhe studentët e sëmurë të qëndrojnë në shtëpi në vetizolim.
- Politikat e pushimeve mjekësore dhe mungesave të justifikuara duhet të japin llogari për punonjësit dhe studentët që kanë nevojë të qëndrojnë në shtëpi me fëmijët e tyre nëse ka mbyllje të shkollave ose kopshtit, ose të kujdesen për anëtarët e sëmurë të familjes.
- Kthimi në mësim me prezencë fizike në objektet e IAL pas kalimit të sëmundjes COVID-19 nga ana e studentëve, stafit akademik dhe personelit joakademik bëhet duke u bazuar në udhëzuesit e IKSHPK për lirim nga vet izolimi.

28. Gjurmimi i kontakteve dhe testimi

Gjurmimi i kontakteve është procesi i njoftimit të personave (kontakteve) për ekspozimin e mundshëm ndaj SARS-CoV-2 dhe bashkëbisedimi në lidhje me virusin, simptomat dhe informacione të tjera të rëndësishme shëndetësore. Gjithashtu jepen udhëzime për vetë-izolim dhe monitorim të simptomave, mbështetje dhe referime për testim, si dhe shërbime të tjera sipas nevojës.

Procesi i hulumtimit të rastit dhe gjurmimit të kontaktit ndihmojnë në parandalimin e transmetimit të mëtejshëm të sëmundjes COVID-19.

Identifikimi i shpejtë, karantinimi dhe monitorimi i këtyre kontakteve të ekspozuara ndaj SARS-CoV-2 mund të ndërprejnë zinxhirin e transmetimit në mënyrë efektive dhe të parandalojnë përhapjen e mëtejshme të virusit në komunitet.

IAL përbëhet nga një komunitet i përzier, me studentë dhe personel të grupmoshave të ndryshme të cilët janë shumë të ndërlidhur përmes kontakteve në konvikte, klasa, salla ligjëratash, ushtrimore, ekipe sportive, klube. Këto raporte të afërta e bëjnë që komuniteti i IAL të jetë më i ndjeshëm ndaj transmetimit në rritje të SARS-CoV-2.

Studentët, stafi akademik dhe personeli joakademik duhet testuar sipas indikacioneve epidemiologjike:

- Kanë shenja ose simptoma në përputhje me COVID-19
- Kanë ekspozim të njohur ose të dyshuar së fundmi ndaj një personi të konfirmuar me SARS-CoV-2 në laborator
- Janë referuar për testim nga ofruesi i shërbimit shëndetësor
- Janë pjesë e një grupi për të cilin rekomandohet testimi (në kontekstin e një shpërthimi)